

VENDIM
Nr. 66, datë 27.1.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 48, DATË 16.1.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MASËN DHE KRITERET E PËRFITIMIT NGA PROGRAMI I NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË NË VËSHTIRËSI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 8, të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 48, datë 16.1.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë përmbajtjen e vendimit, fjalët “... në vështirësi, ...” zëvendësohen me fjalët “... nga grupet e veçanta ...”.

2. Pas shkronjës “c”, të pikës 1, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) Punëdhënësit e rinj, persona juridikë apo fizikë, kanë të drejtë të kërkojnë të përfshijnë në program deri në 40 për qind të numrit të punonjësve të punësuar.”.

3. Pas shkronjës “e”, të pikës 3 shtohet shkronja “f”, me këtë përmbajtje:

“f) viktima të trafikimit.”.

4. Në shkronjën “d”, të pikës 7, fjalët “... Bëjnë përjashtim nga ky rregull, personat juridikë/fizikë, të cilët kanë detyrime ndaj organeve tatimore, por në momentin e aplikimit në këtë program: ...” zëvendësohen me fjalët “... Për personat juridikë apo fizikë, të cilët kanë detyrime ndaj organeve tatimore, por vërtetojnë se, në momentin e aplikimit në këtë program: ...”.

5. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën “b”, fjalët “... numri i të punësuarve dhe i atyre, që kërkohen për t’u punësuar nga punëdhënësi, është jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) persona ...” zëvendësohet me fjalët “... aplikuesit janë persona fizikë ...”.

b) Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit miraton projektet, kur aplikues janë personat juridikë.”.

6. Në pikën 13, pas fjalëve “... Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ...” shtohen fjalët “... pas hedhjes në sistemin përkatës, ...”.

7. Në pikën 15, fjalët “... zyra përkatëse të punësimit ...” zëvendësohen me fjalët “... Shërbimit Kombëtar të Punësimit.”.

8. Në pikën 17, fjalët “... nuk i vazhdohet kompensimi për pagën minimale, në shkallë vendi, por vetëm sigurimet e detyrueshme shoqërore për pjesën e punëdhënësit, për periudhën në vazhdim ...” zëvendësohen me fjalët “... i vazhdohet kompensimi për periudhën e mbetur ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama